



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE**  
**Agjensia Kombëtare e Mjedisit**  
**Drejtoria e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe e Lejeve Mjedisore**  
**Spektori i Lejeve Mjedisore**

Rruga "Durrësit" Nr. 27 Tiranë, Tel. 04 2270 630 Fax. 04 2270 627 – [www.moe.gov.al](http://www.moe.gov.al)

Nr. 305/9 Prot.

Tiranë, më 23 . 07 . 2013

Nr. Identifikues 1353

Vendimi Nr. 19 i KSHK

**Akt - Miratimi**  
**LEJE MJEDISORE**

*Për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit*

Në mbështetje të Ligjit Nr.10431, datë 09.06.2011 " Për mbrojtjen e mjedisit " dhe akteve ligjore e nënligjore që rrjedhin prej tij, subjektit " **DRAGOBIA ENERGY** " Sh.p.k. i jepet leja mjedisore për veprimtarinë:

**1. Përshkrim të veprimtarisë së lejuar:**

- 1.1 Aktiviteti: Ndërtimi hidrocentraleve në kaskadën e Dragobisë.
- 1.2 Vendndodhja: Kaskada e Dragobisë, Rrethi Tropojë.
- 1.3 Kapaciteti: Fuqia totale instaluese 26900 kW, prodhimi vjetor i energjisë 108.836.924 kWh.
- 1.4 Sipërfaqja: totale e pellgjeve ujembledhese 160 km<sup>2</sup> ( Çeremi 29.7 km<sup>2</sup>, Dragobia 130.4 km<sup>2</sup> ) .
- 1.5 Specifikime teknike: ( *gjej bashkangjitur aneksin* )

**2. Të dhëna të mbajtësit të lejes:**

- 2.1 Personi përgjegjës: Artila Ulaj.
- 2.2 Adresa: Rruga " Mustafa Matohiti", pallati 7, shk. 1, zyra 2, Tiranë.
- 2.3 Telefon: +355 42248313.

**3. Kushtet e lejes:**

3.1 Gjate ndërtimit të veprës:

- Ne periudhen e veres , per shkak te kohes se thate, nderhyrjet te behen ne menyre shume te kujdesshme.
- Masat e dheut që gjenerohen nga punimet ndërtimore duhet të mbahen nën kontroll dhe të mos lejohen të rrëshqasin dhe sedimentojnë në rrjedhat ujore në zonën e ndërtimit, përfshirë edhe shtratin e ujembledhësit (rrisin turbullirën, dëmtojnë gjendjen natyrale të lumit, etj.) dhe të sistemohen në vendepozitime të paracaktuara në bashkëpunim me qeverisjen vendore.
- Dherat dhe inertet që do të dalin nga gërmimi i kanalit apo objekteve të tjera të depozitohen në vende të studiuar dhe përpara depozitimit të tyre të aplikohet për Leje Mjedisore për venddepozitimet e tyre, sipas legjislacionit në fuqi.
- Operacionet e ndërtimit të veprave të shmangin në maksimum dëmtimin e tokës dhe pengojnë zhvillimin e proçeseve të degradimit mjedisor, si erozionin etj.

